




ICEBERG
EXHIBITIONS



ENERGY
CONSTRUCTION
& GREEN ECONOMY
TRADE FAIR 2023, OCTOBER 5-6
PALACE OF CONGRESSES, TIRANA



NEW ERA OF EXHIBITIONS



PANAIRI I ENERGJISË, NDËRTIMIT DHE EKONOMISË SË GJELBËR 2023 do të rikthehet sërish në Pallatin e Kongreseve, në qendër të Tiranës në datat 5-6 Tetor 2023. Një pikë takimi për ekspozuesit me qëllim rrjetëzimin dhe një pikë reference për sektorët e energjisë dhe ndërtimit. E ardhmja, siguria dhe qëndrueshmëria e këtyre sektorëve janë thelbësore për ekonominë e Shqipërisë dhe mbarë rajonit tonë. Për këtë arsye, ka një nevojë reale për të ushqyer bashkëpunimin ndër sektorial në lidhje me teknologjitë e reja dhe inovative, produktet, shërbimet dhe zgjidhjet alternative.

Panairi dedikuar sektorëve të energjisë dhe ndërtimit do të fokusohet në çështje të rëndësishme si energjia e rinovueshme, efizienzat energjitike përgjatë të gjithë ciklit të energjisë për çdo sektor, impakti në teknologji, efizienzat në ndërtim dhe impakti mjedisor. “Forumi i Energjisë Tiranë 2023” është një aktivitet paralel që synon të shtojë vlerë për panairin në tërësi. Ky panair dhe forum do të mundësojë ndërveprimin mes prodhuesve dhe furnitorëve të teknologjive më inovatore, produkteve dhe shërbimeve që ofrohen nga industritë e energjisë dhe ndërtimit. Gjithashtu, kjo platformë do të promovojë komunikimin dhe bashkëpunimin mes investitorëve, zhvilluesve dhe konsulentëve.



INFORMACION I PËRGJITHSHËM RRETH SHQIPËRISË

Sektorët e energjisë dhe ndërtimit janë motorët kryesorë të ekonomisë në Shqipëri. Për sa i përket sektorit të energjisë, Shqipëria prodhon të paktën 90% të energjisë elektrike nga hidroçentralet. Për më tepër, sfida të reja si ndryshimet klimatike apo konfliktet ekonomike dhe tregtare në botën tonë, kanë sjellë në vëmendje nevojën për të diversifikuar burimet energjitike (energji diellore dhe të erës). Në këtë këndvështrim, Shqipëria është një ndër vendet me kuadrin më të favorshëm për sa i përket fotovoltaikeve në rajon dhe më gjërë. Për më tepër, vendi ka rrezatim të jashtëzakonshëm të diellit në pjesën më të madhe të territorit të tij. Si rezultat, në vend shënohet numrin më i lartë irrezëve të diellit në vit në të gjithë Evropën. Mesatarisht, Shqipëria ka rreth 286 ditë, me mbi 1500 kWh/m² për vit (në Myzeqe, arrin deri në 1700 kWh/m²/a).m²

Për sa i përket sektorit tjetër, ndërtimit, gjithashtu kërkon zgjidhje më efikente. Tendenca globalisht është drejt digjitalizimit, krijimit të teknologjive moderne dhe miqësore me mjedisin – me qëllim për të rritur efikasitetin, për të diversifikuar format më efikente dhe alternative për prodhimin dhe përdorimin e energjisë, për të reduktuar kostot dhe ndotjen; për të patur një menaxhim më të mirë të ujit dhe sistemeve të ventilimit; për të patur më pak ndërtime dhe infrastrukturë ndotëse; për më tepër vlerë, kosto më të ulët dhe jetëgjatësi më të lartë – këto janë sfidat e Shqiptarëve gjithashtu.

Më tej, duhet theksuar se është tepër e nevojshme rritja e ndërgjegjësimit rreth integritetit të përfitueshmërisë nga përdorimi i teknologjive të rinovueshme dhe vlerës së shtuar që lidhet me faktoret ekonomik, komfortit, stilit të jetesës dhe jetesës së mirë. Gjithashtu në një nivel makro, paraqitet e nevojshme të integrohen strategjitë rreth investimeve, aftësive, punësimit etj. Adresimi i këtyre sfidave dhe kërkesa për të diversifikuar kanalet që mundësojnë rritjen në sektorët e energjisë dhe ndërtimit në Shqipëri përmes nxitjes dhe rritjes së rritjes dhe ma rëndënieve me partnerë kombëtare, rajonale dhe globale është objektivi kryesor i Panairit të Energjisë, Ndërtimit dhe mEkonomisë së Gjelbër 2023 dhe Forumit të Energjisë Tiranë 2023.



PSE DUHET TE MARRËSH PJESË?

- Plot mundësi rjetëzimi, Takime B2B;
- Mundësi biznesi për investitorët e rinj në Shqipëri dhe rajon;
- Informimi dhe rëndësia e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë dhe format e energjisë më bashkëkohore, më eficiente dhe më pak ndotëse;
- Prezantimi i teknologjive dhe shërbimeve më inovatore;
- Promovimi i bashkëpunimit mes aktorëve kryesorë në sektorët e energjisë, mbrojtjes mjedisore, eficientës në ndërtim etj.;
- Inkurajimi i partneriteteve mes aktorëve publike dhe private në Shqipëri dhe rajon.

PROFILI I EKSPOZUESVE:

SEKTORI I ENERGJISË:

- Prodhuesit e energjisë, fotovoltaike, erës, hidroenergjisë, bioenergjisë, gjeotermale, gazit natyror;
- Teknologjitë inovative të kursimit të energjisë;
- Prodhimi dhe instalimi i paneleve diellore;
- Prodhimi dhe montimi i shtyllave eoliane;
- Prodhimi dhe shpërndarja e hidrocentraleve;
- Prodhimi dhe shpërndarja e hidrokarbureve;
- Menaxhimi i energjisë, sistemet automatike, monitorimi;
- Infrastruktura energjetike (transformatorë, rrjete, nënstacione, etj.);
- Teknologji të tjera (LED, pajisjet e transmetimit të energjisë, pajisjet elektrike, menaxhimi i temperaturës, etj.);
- Shtëpi, ndërtesa dhe qytete SMART;
- StartUp, Software;
- Trupa Certifikimi për Sigurinë;
- Pajisjet elektrike.

NDËRTIMI:

- Kompanitë e ndërtimit;
- Ndërtesa SMART;
- Materiale ndërtimi;
- Mjete pune;
- Transporti dhe automjetet e punës;
- Inxhinieri;
- Arkitekturë;
- Puna me metale dhe alumin;
- Lëndë e parë, lëndë e papërpunuar;
- Sisteme hidraulike dhe elemente mbështetëse;
- Sisteme Ngrohje-Ftohje dhe Ventilimi;
- Sistemet e sigurisë;
- Organet e certifikimit të sigurisë.
- Dritare dhe Fasada xhami

OTHERS:

- Mobiliteti (automjetet e gjelbra dhe automjetet me efikasitet energjetik);
- Kërkim, Zhvillim, Konsulencë;
- Çertifikatat;
- Institucionet dhe iniciativat qeveritare;
- Institucionet dhe iniciativat ndërkombëtare;
- Marketingu;
- Shërbimet financiare;
- Arsimi dhe trajnimi;
- Shoqatat.

PROFILE OF VISITORS:

- Sipërmarrësit dhe menaxherët e biznesit që duan të investojnë në efikasitetin e ambienteve të biznesit;
- Operatorët dhe përdoruesit e ndërtesave rezidenciale, tregtare ose industriale;
- Operatorët dhe shitësit e energjisë;
- Zhvilluesit dhe investitorët;
- Zyrtarë qeveritarë dhe lokalë.



TIRANA ENERGY FORUM 2023

Në kuadër të Panairit të Energjisë, Ndërtimit & Ekonomisë së Gjelbër, Av. Lorenc Gordani

Ky event është projektuar si një ditë dedikuar energjisë , me mbi 300 të pranishëm, që do të diskutojnë mbi çështjet kryesore në interes të biznesit, si "bumi" në projektet energjetike dhe eficienta e energjisë në ndërtesa dhe informacione mbi zhvillime të tjera në tregun të energjisë në Shqipëri. Gjatë eventit, do të informoheni nga më ekspertët më të mirë të sektorit mbi çështje aktuale me rëndësi jetike dhe mbi tendencat e momentit nga tregu i energjisë. Tirana Energy Forum 2023 është një forum zyrtar unik që ofron një pasqyrë të plotë të mundësive dhe zhvillimeve të shumta në Shqipëri si një treg energjetik i sapokrijuar në Ballkanin Perëndimor.

Aktiviteti synon të shërbejë si një platformë për mbledhjen e një grupi të jashtëzakonshëm zhvilluesish rajonalë dhe ndërkombëtarë, investitorësh, pronarë asetesh, utilitetesh, politikëbërësish, profesionistësh të industrisë dhe prodhues, që do të diskutojnë mundësitë kryesore për të përfituar nga potenciali i tregut.





ICEBERG
EXHIBITIONS

NEW ERA OF EXHIBITIONS

Iceberg Exhibitions, organizator i panairove dhe eventevenë fushën e biznesit është pjesë e kompanisë Iceberg Communication. Iceberg Communication është një nga agjencitë e para dhe më inovative të marketingut dhe komunikimit, themeluar në Tiranë, në vitin 1999. Për më shumë se dy dekada, ka qënë një aktor vendimtar në ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur në industrinë e menaxhimit të eventeve.

Iceberg Exhibitions organizon panairë dhe evente në fushën e biznesit në sektoret me impakt të rëndësishëm në ekonominë e rajonit si bujqësia, ndërtimi dhe energjia, turizmi etj. Kjo sipërmarrje është iniciativë e një grupi ekspertësh në fushat kryesore dhe me eksperiencë të gjatë në organizimin e panairove në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Objektivi kryesor i Iceberg Exhibitions është të luajë një rol të rëndësishëm në nxitjen e marrëdhënieve strategjike mes rajonit të Ballkanit dhe tregjeve ndërkombëtare, duke bashkuar njerëz dhe duke ndarë vizionin me rajonin. Iceberg

Exhibitions synon të sjellë eventet aty ku sektori ka impaktin më të madh pa u limituar me një venue të caktuar. Eventet tona janë dinamike, gjithëpërfshirëse dhe me interes për bizneset në rajonin e Ballkanit për një përfaqësim të denjë në tregjet ndërkombëtare.

✉ info@icebergexhibitions.com
🌐 www.icebergexhibitions.com

📍 Rr. Tish Dajja, Kompleksi Kika 2,
Nd. 32, H26 (6), Tirana, Albania, 1001
Tel: +355 69 40 63 909

